


# FOTO/ Tentuan vrasjen e biznesmenit, këta janë dy prej të arrestuarve nga policia



© 13:17 - 21 Tetor, 2020



Policia e Tiranës ka njoftuar ditën e sotme se ka arrestuar autorët e dyshuar për atentatin e dështuar ndaj biznesmenit Andon Dhima.

**Abcnews.al** ka mësuar emrat e 4 të arrestuarve, të cilët janë:

**Grid Leno**, 45 vjeç, lindur në Tiranë, i dënuar më par me 6 vite burgim per vjedhje me armë në shtetin Gjerman.

**Albin Hoxha**, 35 vjeç, lindur në Laç dhe banues në Tiranë, i dënuar më par për plagosje me armë.

Në kuadër të këtij operacioni u bë e mundur të identifikohen dhe të ndalohen dy bashkëpunëtorët në këtë ngjarje,shtetasit:

**Maringlen Matohtiti**, 30 vjeç, lindur në Elbasan dhe banues në Tiranë.

**Enea Hoxha** 26 vjeç, lindur në Laç dhe banues në Tiranë, i dënuar më par me 4 vite e 9 muaj per “Prodhim dhe shitje te lendeve narkotike”.

Kapja e tyre u krye pas një punë profesionale nga Komisariati nr.2 në bashkëpunim me strukturat hetimore të DVP-së, nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.




Albin Hoxha

Denoncimi për tentativën e vrasjes së biznesmenit e denoncoi me anë të një video ekskluzive gazetari investigativ Artan Hoxha.

**LEXO edhe: VIDEO EKSKLUZIVE/ Atentat në tentativë ndaj biznesmenit Andon Dhima në Tiranë, ashensori i shpëtoi jetën**

Atentati i mbetur në tentativë ndaj biznesmenit Andon Dhima dështoi mbrëmjen e të enjtes në kryeqytet.



Grid Leno

Në videon e publikuar ekskluzivisht në ABC News, shihen dy persona të maskuar dhe me pistoletë në dorë të cilët ndjekin biznesmenin Dhima kur ky i fundit po shkonte në apartamentin e tij pranë stadiumit Dinamo.

Kanë qenë vetëm 5 sekonda që kanë shpëtuar biznesmenin nga atentati i cili mbeti në tentativë, pasi ky i fundit hyri në ashensor dhe u ngjiti për në banesën e tij, gjë që nuk u la mundësi atentatorëve të finalizonin veprimin.

**LEXO edhe: 5 sekondat që i shpëtuan jetën biznesmenit në Tiranë, momentet e ndjekjes dhe lëvizja e vajzës**

Sakaq, nga veprimet e para hetimore dhe procedurale u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provave materiale: një armë zjarri pistoletë dhe municion luftarak, mjeti në pronësi të shtetasit Albin Hoxha, që dyshohet se është përdorur gjatë ngjarjes, veshjet e përdorura nga autorët, një shkop hekuri policie nga ato me hapje, një palë pranga, 6 telefona celular, rroba uniforme policie dhe kamuflazhi e prova të tjera materiale.

**LEXO edhe: Atentati në tentativë ndaj biznesmenit në Tiranë, Artan Hoxha: Ka denoncuar konfliktin, në dijeni edhe SHBA**

Materialet do t'i kalojnë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësorë Tiranë, për veprime të mëtejshme, për veprat penale “Vrasja” e mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të zjarrit dhe armëve të ftohta” dhe “Mbajtja pa të drejtë e uniformës.

**n.d./abcnews.al**

- Aktualitet
- Video
- Albin Hoxha
- Andon Dhima
- Artan Hoxha
- Atentati
- Enea Hoxha
- Grid Leno
- Maringlen Matohtiti

## Të ngjashme

- Artan Hoxha paralajmëron: Na presin 4 muaj ferri! Lutuni që të mbani frymën deri në spital
- Artan Hoxha zbulon “kleçkën” e shkarkimit të zv.komandantit të Gardës
- “Dole huq”, Gjykata lë në burg 4 të arrestuarit, mesazhi që implikon 2 vëllezërit në atentat



## Minutë pas minute



- © 22:16  
Mediat greke: “Deti” në Gjykatën Ndërkombëtare,...
- © 22:15  
Bartomeu: Ju tregoj pse nuk e lamë Messin të ikte! Pique? Nuk...
- © 22:07  
Zgjedhjet në SHBA, 'përcaktuese' për vazhdimin e dialogut...
- © 21:59  
Vritet terroristi tjetër në Turqi,qytetarët duartrokasin pranë...
- © 21:56  
VIDEO/ Starti i Milanit fantastik, sërish në epërsi kundër Romës

## Më të lexuarat

- Nuk do të mungojnë surprizat, zbuloni shenjat që duhet të bëjnë kujdes
- PAMJE ME DRON/ Si po devijohet lëvizja e makinave nga Dogana! Trafik në hyrje të...
- Shpërthim i fuqishëm në Turqi, dyshohet për sulm terrorist
- Artan Hoxha paralajmëron: Na presin 4 muaj ferri! Lutuni që të mbani frymën deri në spital
- U qëllua me plumb në kokë, gruaja pa gjithçka, fqinji: Ishte i respektuar, autori mund ta ket...

© 22:07 - 26 Tetor, 2020

**Zgjedhjet në SHBA, 'përcaktuese' për vazhdimin e dialogut...**

© 21:59 - 26 Tetor, 2020

**Vritet terroristi tjetër në Turqi,qytetarët duartrokasin pranë...**

© 21:47 - 26 Tetor, 2020

**U zbulua një rast me Covid-19, Kina teston gjithë rajonin me 4.7 milion...**

© 21:22 - 26 Tetor, 2020

**Vijojnë protestat kundër masave anti-Covid në Itali, përplasje mes policisë e...**

© 18:16 - 26 Tetor, 2020

**Nuk ka dyshime, aktorja konfirmon show e ri: Romeo dhe Donaldi flenë...**

© 16:17 - 26 Tetor, 2020

**Ulen testimit, 288 të infektuar, 3 humbje jete dhe 51 të shëruar sot në...**

© 15:54 - 26 Tetor, 2020

**Po kthehet Endri, mungon Eva. Daja i fëmijëve për Abcnews.al: S'dimë ç'po...**

© 15:32 - 26 Tetor, 2020

**Nxirret nga kampi Al-Hol në Siri më i vogli i familjes Dumani, mister fati i së...**

**ABC NEWS AL**  
info@abcnews.al  
+355 67 400 9040

| Rreth nesh                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Harta e faqes |          |         |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|----------|---------|
| ABC NEWS është i pari televizion në Shqipëri që në ditën e parë të transmetimeve nis me lidhje direkte nga 7 studio lokale ne Shkodër, Durrës, Elbasan, Korçë, fier, Vlorë e Gjirokaster. Për të pasuruar gjeografinë e informacionit së shpejti do të mundesohet edhe studio nga Lezha me transmetime live në cdo kohë. Në faqen zyrtare në internet, abcnews.al do të gjeni portalin më të pasur ballkanik me lidhje në rrjetet më të mëdha sociale facebook, twitter si dhe në një prej websiteve më të fuqishëm në kulturën e internetit YOUTUBE. Transmetimi i ABC news është live 24 ore. NUIS/NIPT K01711004F | Aktualitet    | Botë     | Life    |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Politikë      | Ekonomi  | English |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Rajon         | Emisione |         |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Sport         | Moti     |         |

